



**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 – 14

Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	5	64,408,162	11,728,220
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	2,461,216,458	1,336,884,055
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	17,070,245	3,282,748
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	382,270	16,057,533
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>2,543,077,135</b>	<b>1,367,952,556</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive tatimore të shtyra		-	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,543,077,135</b>	<b>1,367,952,556</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	9	2,348,643,373	1,286,128,812
Detyrime tatimore	10	2,633,716	551,397
Të tjera detyrime	11	108,465,622	25,126,363
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>2,459,742,711</b>	<b>1,311,806,572</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>2,459,742,711</b>	<b>1,311,806,572</b>
<b>Kapitali</b>			
Fitimi i ushtrimit		83,334,424	56,145,984
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>83,334,424</b>	<b>56,145,984</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>2,543,077,135</b>	<b>1,367,952,556</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 5 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	3,716,556,180	1,621,174,359
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	13	3,987,157	-
<b>Total të ardhura</b>		<b>3,720,543,337</b>	<b>1,621,174,359</b>
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>		<b>(3,628,493,571)</b>	<b>(1,535,452,298)</b>
Lënda e parë, materiale të konsumueshme	14	(3,618,077,183)	(1,527,937,650)
1) konsumueshme	14		
2) Të tjera shpenzime	15	(10,416,388)	(7,514,648)
<b>Shpenzime të personelit</b>	16	<b>(9,549,312)</b>	<b>(6,802,062)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(8,324,414)	(5,937,909)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(1,224,898)	(864,153)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(163,037)	-
<b>Shpenzime financiare</b>	18	<b>15,731,853</b>	<b>(12,865,900)</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-	-
1) të ngjashme			
2) Shpenzime të tjera financiare		15,731,853	(12,865,900)
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>98,069,270</b>	<b>66,054,099</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	19	<b>(14,734,846)</b>	<b>(9,908,115)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin			
1) fitimin		(14,734,846)	(9,908,115)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>83,334,424</b>	<b>56,145,984</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>83,334,424</b>	<b>56,145,984</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2018</b>	-	-	<b>58,997,698</b>	<b>58,997,698</b>
Fitim / Humbja e vitit	-	-	56,145,984	56,145,984
Dividendë të paguar	-	-	(58,997,698)	(58,997,698)
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	-	-	<b>56,145,984</b>	<b>56,145,984</b>
Fitim / Humbja e vitit	-	-	83,334,424	83,334,424
Dividendë të paguar	-	-	(56,145,984)	(56,145,984)
Transferim në fitime të pashpërndara	-	-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	-	-	<b>83,334,424</b>	<b>83,334,424</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj më 17 korrik 2020 dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Odhise Bresha  
Administrator



  
ILD-99 Audit shpk  
Përgatitësi i pasqyrave

Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	98,069,270	66,054,099
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(15,731,853)	12,865,900
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	(9,908,115)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,152,854,746)	(549,732,949)
Rënie/(rritje) në inventarë	-	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme e te tjera	1,147,936,139	462,201,466
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	15,675,263	(14,158,915)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	-	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	175,094
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>93,094,073</b>	<b>(32,503,420)</b>
Fitim l alokuar	(56,145,984)	(58,997,698)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	93,094,073	(32,503,420)
Mjetet monetare me 1 janar	11,728,220	116,095,238
Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te tjera monetare	15,731,853	(12,865,900)
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>64,408,162</b>	<b>11,728,220</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

“Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj” (Shoqëria) është themeluar më 23 prill 2015 në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë me NIPT L51623028A. Përfaqësues ligjor idegës është Odhise Bresha

Shoqëria është pjesë e shoqërisë së huaj Combined Group Contracting Company (K.S.C.) sha.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është punime civile në territorin e Shqipërisë, punime ndertimi, duke përfshirë ndertesa, rruge, mbikalime, administrimin dhe supervizimin e tyre si dhe prodhimin dhe montimin e materialeve të ndertimit të të gjitha llojeve të tyre.

Selia e Shoqërisë është: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.9, rruga Asim Vokshi, ndertesa 14, hyrja 4, apartamenti 6, Kodi Postar 1016.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të prishme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro /LEK	121.77	123.42
USD /LEK	108.64	107.82

### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



*(Vlerat janë në Lek)*

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(Vlerat janë në Lek)*

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Shoqëria për vitin 2019 nuk zotron aktive Afatgjata materiale.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

#### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

### **4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit**

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

**Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj***(Vlerat janë në Lek)***5. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare ne banke	63,747,318	11,056,040
Mjete monetare ne arke	660,844	672,180
	<u>64,408,162</u>	<u>11,728,220</u>

**6. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kliente	2,461,216,458	1,336,884,055
	<u>2,461,216,458</u>	<u>1,336,884,055</u>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim fitimi parapaguar	1,393,097	-
TVSH e arketueshme	-	482,748
Te arketueshme ndaj punonjesve	2,800,000	2,800,000
Të tjera të arkëtueshme	12,877,148	-
	<u>17,070,245</u>	<u>3,282,748</u>

**8. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të shtyra	382,270	-
Parapagime per materiale & sherbime	-	16,057,533
	<u>382,270</u>	<u>16,057,533</u>

**9. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitoret	2,348,643,373	1,286,128,812
	<u>2,348,643,373</u>	<u>1,286,128,812</u>

**Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj***(Vlerat janë në Lek)***10. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH per t'u paguar	2,602,126	-
Tatimi mbi te ardhurat	31,590	99,631
Tatim Fitimi	-	451,766
	<u>2,633,716</u>	<u>551,397</u>

**11. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga per tu paguar	6,321,349	5,500,287
Renta minerare	383,208	-
Detyrime ndaj Shoqërisë mëmë	-	19,626,076
Hua te marra	101,761,065	-
	<u>108,465,622</u>	<u>25,126,363</u>

**12. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga ndertimet	3,716,556,180	1,621,174,359
	<u>3,716,556,180</u>	<u>1,621,174,359</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Qarkullim i tatueshëm	3,716,556,180
Sipas Kontabilitetit	3,716,556,180
Diferenca	<u>-</u>

**13. Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura financiare	(3,816,806)	-
Azhornimi i arkës	(170,351)	-
	<u>(3,987,157)</u>	<u>-</u>

(Vlerat janë në Lek)

**14. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Materiale te para	114,262,753	-
Nenkontraktore	3,479,847,070	1,527,937,650
Te tjera	23,967,360	-
	<u><b>3,618,077,183</b></u>	<u><b>1,527,937,650</b></u>

**15. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzim qeraje	120,000	120,000
Shpenzime transport & dieta	3,424,160	1,584,000
Energji, uje	33,824	-
Sherbime bankare	527,473	2,596,184
Sherbime postare dhe telekomunikimi	915,029	15,327
Taksa dhe tarifa vendore	428,948	827,710
Shpenzime ligjore e konsulenca	1,699,192	
Shpenzime Sigurimi	2,248,003	1,964,619
Te tjera	966,427	406,808
Tarife skanimi në doganë	53,332	-
	<u><b>10,416,388</b></u>	<u><b>7,514,648</b></u>

**16. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Paga personeli	8,324,414	5,937,909
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,224,898	864,153
	<u><b>9,549,312</b></u>	<u><b>6,802,062</b></u>

**17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet si dhe shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoba dhe demshperblime	163,037	-
	<u><b>163,037</b></u>	<u><b>-</b></u>

**Combined Group Contracting Company (K.S.C.) Dege e shoqërisë së huaj***(Vlerat janë në Lek)***18. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime financiare-Kurs kembimi	-	18,638,842
Te ardhura te tjera financiare-Kurs Kembimi	(15,731,853)	(5,772,942)
	<u>(15,731,853)</u>	<u>12,865,900</u>

**19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	98,069,270	66,054,099
Total shpenzime të panjohura	163,037	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	98,232,307	66,054,099
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	14,734,846	9,908,115
	<u>83,334,424</u>	<u>56,145,984</u>

**20. Angazhime dhe pasiguri***Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

**21. Ngjarje pas bilancit**

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.